

VENDIM
Nr. 780, datë 19.12.2025

PËR SHPALLJEN E DISA ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E
EKONOMISË MALORE NË BASHKINË VAU I DEJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025, “Për paketën e maleve”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore” në territorin e Bashkisë Vau i Dejës të disa zonave, si më poshtë vijon:

a) Zona zhvillimore nr. 1, Barbullush, pjesë e Njesisë Administrative Bushat, me sipërfaqe 41.35 (dyzet e një pikë tridhjetë e pesë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto;

b) Zona zhvillimore nr. 2, Lugina e Drinit, pjesë e njësive administrative Temal, Shllak dhe Vau i Dejës, me sipërfaqe 7 930.82 (shtatë mijë e nëntëqind e tridhjetë pikë tetëdhjetë e dy) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto;

c) Zona zhvillimore nr. 3, Bushat, pjesë e Njesisë Administrative Bushat, me sipërfaqe 188.89 (njëqind e tetëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë e nëntë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto;

ç) Zona zhvillimore nr. 4, Shllak, Njësia Administrative Shllak, me sipërfaqe 931.76 (nëntëqind e tridhjetë e një pikë shtatëdhjetë e gjashtë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto;

d) Zona zhvillimore nr. 5, Mnelë, pjesë e Njesisë Administrative Vig–Mnelë, me sipërfaqe 116.48 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë dyzet e tetë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto;

dh) Zona zhvillimore nr. 6, Nënshat, pjesë e Njesisë Administrative Hajmel, me sipërfaqe 355.78 (treqind e pesëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e tetë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto.

2. Shtrirja, kufijtë, pikat e hyrjes dhe të daljes së këtyre zonave përcaktohen në hartën treguese, sipas sistemit KRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e aktiviteteve që do të zhvillohen në këtë zonë janë:

a) të zhvillimit ekonomik;

b) të zhvillimit industrial;

c) të zhvillimit turistik.


4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Vau i Dejës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLANVENDOSJA E ZONËS ZHVILLIMORE BARBULLUSH
SHKALLA 1:5 000 (KRGJSH)
SIPËRFAQJA = 41.35 HA

045/SHK/2020




GRUPI I PUNËS

Ervis Prgci Ana Shmytha Marinela Deda Mark Suli Armand Velaj Elsa Tanushi Ceko Suka Pjetër Delija Kristian Ndoja Sandër Nikolli Klodian Daja

849H/000

PLANVENDOSJA E ZONËS ZHVILLIMORE LUGINA E DRINIT
SHKALLA 1:70 000 (KRGJSH)
SIPËRFAQJA = 7930.82 HA



GRUPI I PUNËS

Ervis Preçi Ana Shurdha Marinela Deda Mark Suli Armand Velaj Elsa Tanushi Çekçe Şuka Pjetër Delija Kristian Ndoja Sander Nikolli Klodian Daja

PLANVENDOSJA E ZONËS ZHVILLIMORE BUSHAT
SHKALLA 1:7 000 (KRGJSH)
SIPËRFAQJA = 188.89 HA



GRUPI I PUNËS

Ervis Preci Ana Shurdha Marinela Deda Mark Suli Armand Velaj Elsa Tanushi Ceke Suka Pjetër Delija Kristian Ndoja Sandër Nikolli Klodian Daja



PLANVENDOSJA E ZONËS ZHVILLIMORE SHLLAK
SHKALLA 1:20 000 (KRGJSH)
SIPËRFAQJA = 931.76 HA



GRUPI I PUNËS

Ervis Preci, Ana Shpirdha, Marinela Deda, Mark Suli, Armand Velaj, Elsa Tanushi, Ceke Suka, Pjetër Delija, Kristian Ndoja, Sandër Nikolli, Klodian Daja



PLANVENDOSJA E ZONËS ZHVILLIMORE MNEL
SHKALLA 1:7 000 (KRGJSH)
SIPËRFAQJA = 116.48 HA




GRUPI I PUNËS

Ervis Preci Ana Shurdha Marinela Deda Mark Suli Armand Velaj Elsa Tanushi Ceke Suka Pjetër Delija Kristian Ndoja Sandër Nikolli Klodian Daja



PLANVENDOSJA E ZONËS ZHVILLIMORE NËNSHAT
SHKALLA 1:10 000 (KRGJSH)
SIPËRFAQJA = 355.78 HA



GRUPI I PUNËS

Ervis Preci Ana Shurdha Marinela Deda Mark Shtij Armand Velaj Elsa Tanushi Ceke Suka Pjetër Delija Kristian Ndoja Sandër Njollli Klodian Daja